



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 76 Prot.

Vlorë, më 07 / 07 / 2020

V E N D I M

Nr. 02, datë 07.07.2020

**"PËR MIRATIMIN PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT DIND,
BACHELOR DHE PROFESIONAL 2 VJEÇAR, NË KOLEGJIN UNIVERSITAR
"PAVARËSIA VLORË", PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022"**

Bazuar në nenin 47, neni 48, pika "dh", të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 9, pika 1, germa "dh" dhe "g", të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit; Vendimit të Senatit Akademik nr. 24, datë 10.01.2017 "Për miratimin e programeve të studimit 5-vjeçar në fushën e Drejtësisë, si dhe përcaktimin e kriterëve shtesë për efekt rankimi, për pranimin në programet e studimit, në Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë", për vitin akademik 2017-2018"; Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të MASR "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë";

Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë";

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, për hapjen e programit të studimit 5 vjeçar DIND/Master i Shkencave në "Drejtësi";
2. Miratimin e propozimit të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, për hapjen e programit të studimit Profesional 2 vjeçar në "Asistent i Lartë Administrativ";
3. Miratimin e propozimit të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, për hapjen e programit të studimit Profesional 2 vjeçar në "Menaxhim në Turizëm dhe Hoteleri";
4. Miratimin e propozimit të Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, për hapjen e programit të studimit 3 vjeçar Bachelor në "Inxhinieri Mekanike";
5. Miratimin e propozimit të Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, për hapjen e programit të studimit Profesional 2 vjeçar në "Databazë dhe Web Design";



6. Miratimin e propozimit të Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, për hapjen e programit të studimit Profesional 2 vjeçar në "Specialist Teknologji Informacioni dhe Rrjeta";
7. Miratimin e propozimit të Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, për hapjen e programit të studimit Bachelor në "Dizajn Arkitektural";
8. Të dërgojë për miratim propozimet në Senatin Akademik të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë";
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Gëzim LIÇAJ